REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SARANDË**

Nr. 4198 prot. Sarandë, më 02.06.2026

**URDHËR**

Nr. 152 Datë 02.06.2026

**" PËR DISIPLINIMIN E ORAREVE TË QARKULLIMIT TË MJETEVE MOTORIKE DHE FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NGA SUBJEKTET TREGTARE GJATË SEZONIT TURISTIK 2026"**

Në mbështetje të nenit 113 pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja a , neni 64 të ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 28, pika 2, te ligjit nr. 44/2015,"Kodi i Proçedurave Administrative i Republikes së Shqipërise",Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" i ndryshuar neni 8, Udhëzimin e përbashkët nr.2 datë 15.11.2023 të Ministrisë së Turizmit, Ministrisë së Shëndëtësisë dhe mbrojtjes sociale dhe Ministrisë së Brendshme ,

**URDHËROJ:**

1. Veprimtaria e mjeteve të rënda të ndërtimit si çekiç, fadroma, betoniera etj të ndërpritet për periudhën 15 Qershor – 30 Shtator , ndërsa për periudhën 1 tetor – 31 maj të vitit pasardhës do të punojnë në intervalet kohore 08$^{oo}$ - 14$^{oo}$ dhe 17$^{oo}$ - 20$^{oo}$.
2. Oraret e furnizimit të subjekteve tregëtare dhe njësive të tjera të shërbimit për periudhën 1 Qershor – 30 Shtator do të jenë:
   - Me automjete mbi 3,5 ton nga ora 24$^{oo}$ - 09 $^{oo}$
   - Me automjete deri në 3,5 ton nga ora 24$^{oo}$ - 09 $^{oo}$ dhe 13$^{oo}$ - 17$^{oo}$
3. Oraret e lejuara për zhvillimin e aktivitetit nga njësitë e shërbimit të parashikuara në aneksin 2 të Udhëzimin e përbashkët nr.2 datë 15.11.2023 të Ministrisë së Turizmit, Ministrisë së Shëndëtësisë dhe mbrojtjes sociale dhe Ministrisë së Brendshme , do të jetë si më poshtë:
   a. Për periudhën tetor – maj 08$^{oo}$ - 14$^{oo}$
      17$^{oo}$ - 20$^{oo}$
   b. Për periudhën qershor - shtator 08$^{oo}$ - 14$^{oo}$
      17$^{oo}$ - 21$^{oo}$
4. Përjashtim nga parashikimet e pikës 2 të këtij urdhri , do të jenë:
   - Rastet e mjeteve të cilat kryejnë furnizimin e njësive tregtare dhe të shërbimet me produktet ushqimore të ngrira
   - Rastet e mjeteve të cilat kryejnë veprimtari për realizimin e punimeve në shërbim të investimeve publike të Bashkisë Sarandë
   - Rastet e mjeteve të cilat qarkullimi i tyre paraqitet i nevojshëm dhe kërkohet për një afat kohor të përcaktuar

Në të gjitha rastet e mësipërme mjetet duhet të jenë pajisur me autorizimin përkatës lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të cilët do të jenë të detyruar të respektojnë kushte e vendosura në të.

Përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij urdhri , do të jenë rastet e mjeteve të cilat kryejnë veprimtari për realizimin e punimeve në shërbim të investimeve publike të Bashkisë Sarandë të cilët do të pajisen me autorizimin përkatës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike."

5. Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit me detyrat si më poshtë:
   - të kontrollojnë zbatimin e orareve të përcaktuara më lartë duke kërkuar edhe sipas rasteve mbështetjen e Policisë së Shtetit
   - të lajmërojë subjektet ndërtuese për oraret e punës së mjeteve të rënda të përcaktuara në këtë urdhër dhe të kontrollojë zbatimin e orareve
   - të kryej ndalimin e menjëhershëm të veprimtarive të cilat prishin pushimin dhe qetësinë e qytetarëve
6. Ky urdhër hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë sipas nenit 8 pika a të Ligjit 107/2016 " Për Prefektin e Qarkut" .
7. Për zbatimin e këtij urdhri , ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike , Policia Bashkiake dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

**KRYETAR**

**Oltion ÇAÇI**